



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 156

Tiranë – E Premte, 10 Tetor 2014

PËRMBAJTJA

Faqe

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 19.9.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597, datë 10.9.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2014, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, për mbulimin e shpenzimeve për shtesë punimesh në zbatim të projekteve “Për rikonstruksionin e Pallatit të Kongreseve” dhe “Për realizimin e Qendrës Mediatike në Pallatin e Kongreseve”	8017
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 628, datë 29.9.2014	Për përcaktimin e medaljeve që do të jepen me rastin e 70 - Vjetorit të Çlirimit të Vendit	8017
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 631, datë 1.10.2014	Për dhënien e ndihmës financiare nga qeveria shqiptare për qeveritë e Bosnjë-Hercegovinës dhe Serbisë për lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet në maj 2014	8021
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 632, datë 1.10.2014	Për shfuqizimin e vendimit nr. 133, datë 24.2.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e task-forcës për kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar gjatë viteve të regjimit komunist”	8021
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 636 , datë 1.10.2014	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën simbolike 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë “Tur-tekstil”, sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Ish-ndërmarrja gjeofizike, Patos”	8021
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 637, datë 1.10.2014	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën simbolike 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë “Liberest”, sh.p.k., për pasurinë “Agjencia e Rezervave të Shtetit Dorëz, komuna Qendër, Librazhd”.....	8022
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 638, datë 1.10.2014	Për një shtesë dhe ndryshim në vendimin nr. 1, datë 8.1.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar.....	8022

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 639, datë 1.10.20014	Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Shëndetësisë te Bashkia Lushnjë, të një pjese të godinës nr. 4 (Ish-reparti infektiv), pranë spitalit “Thsan Çabej”, Lushnjë.....	8024
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 640, datë 1.10.2014	Për rishpërndarje fondesh buxhetore brenda programeve të miratuara në buxhetin e vitit 2014 për Ministrinë e Shëndetësisë	8025
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 641, datë 1.10.2014	Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte	8025
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 644, datë 1.10.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrjetit kryesor të kanalizimeve dhe impiantit të përpunimit të ujërave të përdorura në plazhin e Velipojës	8035
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 645, datë 1.10.2014	Për ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Çmimit të Barnave.....	8037
Udhëzim i Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 12, datë 29.9.2014	Mbi zbatimin e vendimit nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar.....	8039
Udhëzim i Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 13, datë 29.9.2014	Mbi zbatimin e vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, të ndryshuar.....	8039
Udhëzim i Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 14, datë 29.9.2014	Mbi zbatimin e vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar	8040

**VENDIM****Nr. 618, datë 19.9.2014**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 597, DATË 10.9.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
RISHPËRNDARJE FONDESH NË
BUXHETIN E VITIT 2014, NDËRMJET
MINISTRISË SË KULTURËS DHE
DREJTORISË SË SHËRBIMEVE
QEVERITARE, PËR MBULIMIN E
SHPENZIMEVE PËR SHTESË
PUNIMESH NË ZBATIM TË
PROJEKTEVE “PËR
RIKONSTRUKSIONIN E PALLATIT TË
KONGRESEVE” DHE “PËR REALIZIMIN
E QENDRËS MEDIATIKE NË PALLATIN
E KONGRESEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 597, datë 10.9.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për rishpërndarje fondesh, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Kulturës, për mbulimin e shpenzimeve për shtesë punimesh në zbatim të projekteve “Për rikonstruksionin e Pallatit të Kongreseve” dhe “Për realizimin e Qendrës Mediatike në Pallatin e Kongreseve”.

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2014 të bëhet rishpërndarja e fondeve, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Kulturës t’i shtohet fondi prej 2 800 000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekësh, për shpenzime kapitale, në programin “Trashëgimia kulturore dhe muzetë”, për mbulimin e shpenzimeve të kontratës shtesë të punimeve në zbatim të projektit “Për rikonstruksionin e Pallatit të Kongreseve”.

b) Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare t’i pakësohet fondi prej 2 800 000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekësh, në shpenzimet kapitale.

3. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Ministrisë së Kulturës, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, t’i shtohet fondi prej 21 507 334 (njëzet e një milionë e pesëqind e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekësh, ndarë, si më poshtë vijon:

a) 3 531 173 (tre milionë e pesëqind e tridhjetë e një mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë, për shpenzime kapitale, për mbulimin e shpenzimeve të kontratës shtesë të punimeve në zbatim të projektit “Për rikonstruksionin e Pallatit të Kongreseve”.

b) 8 900 000 (tetë milionë e nëntëqind mijë) lekë, për shpenzime korrente, për mbulimin e shpenzimeve për projektin “Për realizimin e Qendrës Mediatike në Pallatin e Kongreseve”.

c) 9 076 161 (nëntë milionë e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e një) lekësh, për shpenzime korrente, për mbulimin e shpenzimeve “Për realizimin e pjesëve të dekorit të Altarit”.

Fondi prej 21 507 334 (njëzet e një milionë e pesëqind e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekësh, të përballohet nga fondi i kontingjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2014.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 628, datë 29.9.2014**

**PËR PËRCAKTIMIN E MEDALJEVE QË
DO TË JEPEN ME RASTIN E
70 - VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË VENDIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 112/2013, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, dhe të vendimit nr. 541, datë 7.8.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2014, miratuar për disa institucione për festimet e 70 - Vjetorit të Çlirimit të Vendit”, me propozimin e ministrit të Mbrotjes, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Përcaktimin e medaljeve që do të jepen me rastin e 70 - Vjetorit të Çlirimit të Vendlit, si më poshtë vijon:

a) “Medalja e mirënjohjes” të jepet për personat që kanë dhënë një kontribut të veçantë duke marrë pjesë në luftën për mbrojtjen e vendlit në periudhën 7 prill 1939 - 29 nëntor 1944. Përcaktimet për “Medaljen e mirënjohjes” dhe forma e saj jepen në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) “Medalja e nderit” të jepet për personelin e Forcave të Armatosura dhe personelin e Policisë së Shtetit për trimëri, guxim, për merita e shërbime të veçanta, kontribut të spikatur në detyrë, duke rrezikuar edhe jetën, dhe për merita të shquara në ushtrimin me përgjegjësi të detyrave. Përcaktimet për “Medaljen e nderit” dhe forma e saj jepen në lidhjen nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Dhënia e medaljeve shoqërohet me certifikatë, formati i së cilës është letër A4 (210 mm x 297 mm), 160 g/m², me fushë me stemën e institucionit, me kornizë me shirit anash.

Përcaktimet për certifikatën shoqëruese të medaljes dhe forma e saj jepen në lidhjet nr. 3 dhe nr. 4, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

3. Sasia për “Medaljen e mirënjohjes” është 1 000 (një mijë) copë, që jepen nga ministri i Mbrojtjes.

4. Sasia për “Medaljen e nderit” është 20 (njëzet) copë, gjithsej, nga të cilat 10 (dhjetë) copë jepen nga ministri i Mbrojtjes dhe 10 (dhjetë) copë nga ministri i Punëve të Brendshme.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i dhënë për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme me vendimin nr. 541, datë 7.8.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2014, miratuar për disa institucione për festimet e 70 - Vjetorit të Çlirimit të Vendlit”.

6. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes dhe ministri i Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MEDALJES
SË MIRËNJOHJES

Diametri: 40 mm;

Trashësia: 3 mm;

Materiali: Tunxh;

Teknika: Stampim (jo me derdhje);

Unaza: Horizontale me gjerësi 15 mm;

Sipërfaqja: Pasqyrë, ndërsa relievi i satinuar;

Shiriti: Methurje ngjyrë kuq e zi, me gjerësi 30 mm dhe gjatësi 60 cm, përbërja prej pambuku-poliester, i cili kapet me medaljen në pjesën e sipërme të saj.

Varja: Në qafë, me shirit me gjatësi 60 cm.

Modeli i medaljes: sipas skicës bashkëlidhur kësaj shkrese.

Kjo medalje do të jetë e shoqëruar me certifikatën e medaljes me letër kartoni ngjyrë krem i hapur me format A4.

Medalja do të jetë e vendosur në një kuti të veshur me kadife të kuqe, me hapje nga sipër, përmasat e të cilës do të jenë 120x90x30mm. Kutia nga brenda do të jetë me sfungjer, e mbuluar me atlas të bardhë.

Lidhja nr. 2

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MEDALJES
SË NDERIT

Diametri: 30 mm;

Trashësia: 3 mm;

Materiali: Tunxh;

Teknika: Stampim (jo me derdhje);

Unaza lidhëse: 2 unaza me diametër 5 mm

Sipërfaqja: Pasqyrë, ndërsa relievi i satinuar;

Pjesa kapëse: Medalja do të kapet me një pllakë metalike tunxhi, në formë trapezi 5-këndor, me bazë nga sipër, nëpërmjet 2 unazave të cilat janë me diametër 5 mm dhe do të lidhin pllakën metalike me medaljen. Pjesa e përparme e pllakës metalike mbajtëse, do të ketë të stampuar tre shirita vertikale, 2 të kuq me gjerësi 10 mm anash, dhe një shirit të zi me gjerësi 10 mm në mes. Në pjesën e pasme të pllakës mbajtëse, të jetë montuar mekanizmi i kapjes me karficë.

Këto medalje do të jenë të shoqëruara me certifikatën e medaljes, e cila është letër kartoni ngjyrë krem i hapur, me format A4.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES**

**MINISTRI I MBROJTJES
I JEP**

Grada/Z/Znj

MEDALJEN

.....
LLOJI I MEDALJES

PËR.....
.....
.....

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES**

Dhënë me urdhrin nr. __, datë __ / __ / __ të Ministrit të Mbrojtjes

Ministër







REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
I JEP

Grada/Z/Znj

MEDALJEN

.....

LLOJI I MEDALJES

PËR.....

.....

.....

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E PUNËVE

TE BRENDSHME

Dhënë me urdhrin nr. __, datë __ / __ / __ të

Ministrit të Punëve të Brendshme

Ministër

**VENDIM****Nr. 631, datë 1.10.2014**

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS
FINANCIARE NGA QEVERTIA
SHQIPTARE PËR QEVERTITË E
BOSNJË-HERCEGOVINËS DHE
SERBISË PËR LEHTËSIMIN E
PASOJAVE TË DËMEVE TË
SHKAKTUARA NGA PËRMBYTJET
NË MAJ 2014**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 10, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e ndihmës financiare nga qeveria shqiptare për qeveritë e Bosnjë-Hercegovinës dhe Serbisë, përkatësisht, nga 100 000 (njëqind mijë) euro, për lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet në maj 2014.

2. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në programin buxhetor 01120 “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”, t’i shtohet kundërvlera në lekë e fondit prej 200 000 (dyqind mijë) eurosh, shpenzime korrente, për t’u përdorur si ndihmë financiare për lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet e muajit maj 2014, në Bosnjë - Hercegovinë dhe Serbi.

3. Ky fond të përballohet nga fondi i kontingjencës, miratuar për vitin 2014.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 632, datë 1.10.2014**

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.
133, DATË 24.2.2010, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E TASK-
FORCËS PËR KËRKIMIN, GJETJEN
DHE IDENTIFIKIMIN E PERSONAVE
TË EKZEKUTUAR GJATË VITEVE TË
REGJIMIT KOMUNIST”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shfuqizimin e vendimit nr. 133, datë 24.2.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Task-Forcës për kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar gjatë viteve të regjimit komunist”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 636, datë 1.10.2014**

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR
LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË
ME TARIFËN SIMBOLIKE 1
EURO/KONTRATA, NDËRMJET
MINISTRISË SË ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË DHE
SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS, DHE
SHOQËRISË “TUR-TEKSTIL”, SHPK, SI
QIRAMARRËS, PËR PASURINË “ISH-
NDËRMARRJA GJEOFIZIKE, PATOS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën simbolike 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë “Tur-Tekstil” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Ish-Ndërmarrja Gjeofizike, Patos”, me sipërfaqe të përgjithshme 12 507 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatë) m².

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 637, datë 1.10.2014

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR
LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË
ME TARIFËN SIMBOLIKE 1
EURO/KONTRATA, NDËRMJET
MINISTRISË SË ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË DHE
SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS, DHE
SHOQËRISË “LIBEREST”, SHPK, PËR
PASURINË “AGJENCIA E REZERVAVE
TË SHTETIT DORËZ, KOMUNA
QENDËR, LIBRAZHD”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën simbolike 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë “Liberest” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Agjencia e Rezervave të Shtetit Dorëz,

komuna Qendër, Librazhd”, me sipërfaqe të përgjithshme 38 200 (tridhjetë e tetë mijë e dyqind) m².

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 638, datë 1.10.2014

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR. 1, DATË 8.1.2014, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
FINANCIMIN E SHËRBIMEVE
SHËNDETËSORE SPITALORE NGA
SKEMA E DETYRUESHME E
SIGURIMEVE TË KUJDESIT
SHËNDETËSOR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1, datë 8.1.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas shkronjës “b”, të pikës 4, shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) pagesat e trajtimeve jashtë vendit, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave, rast pas rasti.”.

2. Shtojca 2/1, që i bashkëlidhet vendimit, zëvendësohet me shtojcën 2/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



SHTOJCA 2/1

BUXHETI I SHËRBIMIT SPITALOR 2014

Nr	Spitalet	Nr. i punonjësve	Buxheti 2014				
			paga	sigurime	mallra e shërbime	rezervë	total
1	Berat	392	224,000	37,200	166,900		428,100
2	Bulqizë	105	58,100	9,500	25,059		92,659
3	Delvinë	32	19,500	3,090	6,850		29,440
4	Devoll	57	31,700	5,310	12,050		49,060
5	Dibër	383	213,000	34,640	127,847		375,487
6	Elbasan	657	364,500	60,560	209,250		634,310
7	Fier	526	290,000	48,050	356,482		694,532
8	Gramsh	164	96,000	16,030	42,104		154,134
9	Gjirokastër	260	150,200	24,500	114,960		289,660
10	Has	43	25,400	4,100	12,800		42,300
11	Kavajë	169	95,500	16,300	34,103		145,903
12	Kolonjë	135	74,380	12,250	20,766		107,396
13	Korçë	589	329,500	54,680	217,356		601,536
14	Kruje	177	103,000	17,130	34,000		154,130
15	Kuçovë	77	47,000	7,450	18,500		72,950
16	Kukës	323	178,100	28,620	81,943		288,663
17	Laç	99	56,100	9,320	26,056		91,476
18	Lezhë	279	164,000	26,800	101,472		292,272
19	Librazhd	209	120,500	19,725	50,600		190,825
20	Lushnjë	312	178,000	29,150	115,780		322,930
21	Malësi e Madhe	17	11,600	1,800	6,000		19,400
22	Mallakastër	39	23,600	3,820	11,650		39,070
23	Mat	203	109,500	18,250	48,000		175,750
24	Mirdite	155	87,610	15,635	34,000		137,245
25	Peqin	30	19,900	2,985	9,018		31,903
26	Përmet	134	74,500	12,200	26,061		112,761
27	Pogradec	255	144,200	23,660	74,000		241,860
28	Puke	155	85,200	13,800	33,086		132,086
29	Sarandë	200	118,000	19,000	61,875		198,875
30	Skrapar	145	79,200	12,930	17,073		109,203
31	Shkodër	794	440,000	73,130	245,000		758,130
32	Tepelenë	171	94,700	15,600	27,000		137,300
33	QSUT	2,792	1,617,046	271,303	4,092,007		5,980,356
34	Mat. nr. 1	379	226,979	36,847	185,000		448,826
35	Mat. nr. 2	286	180,279	30,247	185,000		395,526
36	Sanatoriumi	343	182,000	29,500	267,000		478,500
37	Tropojë	163	88,000	14,240	34,800		137,040
38	Vlorë	584	324,000	54,120	177,200		555,320
39	SU Trauma	325	214,569	30,763	440,300		685,632
	paketa spitalore					0	0
	paketa për trajtime jashtë vendit					50,000	50,000
	rezervë e pashpërndarë					133,254	133,254
	TOTALI	12,158	6,939,363	1,144,235	7,748,948	183,254	16,015,800

**VENDIM****Nr. 639, datë 1.10.20014**

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË TE
BASHKIA LUSHNJË, TË NJË PJESE TË
GODINËS NR. 4 (ISH-REPARTI
INFEKTIV), PRANË SPITALIT “IHSAN
ÇABEJ”, LUSHNJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 6, 7 dhe 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Shëndetësisë te Bashkia Lushnjë, të një pjese të


godinës nr. 4 (ish-reparti infektiv), pranë spitalit “Ihsan Çabej”, Lushnjë, me sipërfaqe 500 m², zona kadastrale 8571, ndodhur në katin përdhës, sipas planvendosjes dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi, për rikonstruksion dhe ngritjen e Qendrës Ditore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuara.

2. Bashkisë Lushnjë i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen ministri i Shëndetësisë, kryetari i Bashkisë Lushnjë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama





Planimetria e godines ne spitalin I'HSAN ÇABEJ
Lagja " Xhevdet Nepravishta " LUSHNJE
Kati Perdhe , SH 1:150



VENDIM

Nr. 640, datë 1.10.2014

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE BRENDË PROGRAMEVE TË MIRATUARA NË BUXHETIN E VITIT 2014 PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 07220, “Shërbimet e kujdesit parësor”, në artikullin 604, “Të tjera transferime korrente të brendshme”, të pakësohet fondi prej 350 000 000 (treqind e pesëdhjetë milionë) lekësh.

b) Në programin buxhetor 07330, “Shërbimet e kujdesit dytësor”, në artikullin 604, “Të tjera transferime korrente të brendshme”, të shtohet fondi prej 350 000 000 (treqind e pesëdhjetë milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 641, datë 1.10.2014

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR EKSPORTIN E MBETJEVE DHE KALIMIN TRANSIT TË MBETJEVE JO TË RREZIKSHME E TË MBETJEVE INERTE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 50 e 51, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Qëllimi i këtij vendimi është mbrojtja, ruajtja dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit, si dhe mbrojtja e shëndetit publik, përmes minimizimit të ndikimeve negative nga eksporti i mbetjeve dhe kalimi transit i mbetjeve jo të rrezikshme apo i mbetjeve inerte. Objekt i këtij vendimi janë të gjitha llojet e mbetjeve, të cilat janë objekt i ligjit nr. 10463/2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

2. Ky vendim rregullon procedurat e:

a) qarkullimit ndërkufitar të eksportit të mbetjeve lidhur me origjinën, destinacionin dhe rrugën e transportit që do të ndjekin mbetjet nga origjina deri në destinacionin përfundimtar dhe llojin e trajtimit që do t’u bëhet mbetjeve në destinacion;

b) kalimit transit të mbetjeve jo të rrezikshme ose inerte lidhur me origjinën, destinacionin dhe rrugën e transportit që do të ndjekin mbetjet nga origjina deri në destinacionin përfundimtar.

3. Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorur në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, ndërsa me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

a) “Autoritet kompetent i dërgimit”, autoriteti kompetent për territorin nga i cili është planifikuar të nisët transferta ose është nisur;

b) “Autoritet kompetent i destinacionit”, autoriteti kompetent për territorin në të cilin transferta është planifikuar ose po kryhet;

c) “Autoritet kompetent i transitit”, autoriteti kompetent për çdo vend, përveç autoritetit kompetent të dërgimit apo destinacionit, përmes të cilit transferta është planifikuar ose kryhet;

ç) “Vend i daljes”, çdo vend nga i cili është planifikuar të nisët transferta e mbetjeve ose është nisur;

d) “Vend i destinacionit”, çdo vend në të cilin transferta e mbetjeve është planifikuar ose bëhet për rikuperim apo asgjësim;

dh) “Vend transit”, çdo vend, përveç vendit të daljes ose destinacionit, përmes të cilit transferta e mbetjeve është planifikuar ose kryhet.

4. Ky vendim zbatohet për llojet e mbetjeve sipas:

a) vendimit nr. 99, datë 18.2.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Katalogut Shqiptar të Mbetjeve”, të ndryshuar;

b) kodit përkatës të listës së Konventës së Bazelit në përputhje me ligjin nr. 8216, datë 13.5.1997, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Bazelit për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”;

c) Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave doganore në fuqi.

5. Ministri përgjegjës për mjedisin jep autorizim për personat që kërkojnë:

a) të eksportojnë mbetje;

b) të transitojnë mbetje jo të rrezikshme ose inerte.

6. I nënshtrohen procedurës së njoftimit dhe miratimit paraparak duke plotësuar aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi, personat që kërkojnë të eksportojnë:

a) mbetje të rrezikshme për qëllim asgjësimi ose rikuperimi;

b) mbetje jo të rrezikshme që destinohen për qëllim asgjësimi.

7. Për t’u pajisur me autorizim për eksportin e mbetjeve sipas përcaktimit në pikën 6, të këtij vendimi, personi përgatit dhe dorëzon në ministrinë përgjegjëse për mjedisin dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesën, në të cilën shprehen qartë: të dhënat personale (emri i personit fizik dhe/ose juridik); një përshkrim i mbetjeve që do të eksportohen, ku të përcaktohen lloji dhe sasia e mbetjeve, vendi i origjinës së mbetjeve, vendi i importit dhe vendet e kalimit transit; mjetet e transportit të mbetjeve të rrezikshme të pajisura me certifikatën e miratimit të mjetit, sipas ADR-së, në zbatim të ligjit nr. 118/2012, datë 13.12.2012, “Për transportin e mallrave të rrezikshme”, nëse këto mbetje përfshihen në aneksin A të ADR-së; mënyra e paketimit dhe/ose ambalazhimit dhe etiketimit të mbetjeve.

b) Kopjen e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) për objektin e veprimtarisë.

c) Kopjen e lejes së mjedisit të tipit A, B ose C, sipas përcaktimit në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.

ç) Kopjen e licencës III.2.B, sipas vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për



licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar.

d) Kopjen e noterizuar të përkthimit në gjuhën shqipe të kontratës së lidhur midis personit që eksporton dhe personit që merr në dorëzim mbetjet për menaxhimin e integruar të tyre.

dh) Formularin e plotësuar, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

e) Faturën e garancisë financiare apo sigurimit ekuivalent, sipas përcaktimit në pikën 20, të këtij vendimi.

ë) Faturën (mandat-arkëtimi) që provon se ka paguar tarifën e shërbimit në llogarinë bankare të Ministrisë, në shumën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, e cila është e pakthyeshme.

8. Kontrata, sipas shkronjës “d”, të pikës 7, e lidhur midis personit që eksporton mbetjet dhe personit që i merr në dorëzim mbetjet për t’i menaxhuar, duhet të jetë efektive që nga aplikimi për autorizimin për eksport deri në përfundim të vlefshmërisë së autorizimit për të gjithë kohëzgjatjen e transfertave të mbetjeve.

9. Ministria njofton në rrugë zyrtare autoritetin kompetent të destinacionit dhe autoritetin/et kompetent/e të transitit në momentin e marrjes së kërkesës për eksport të mbetjeve sipas pikës 7, të këtij vendimi.

10. Njoftimi bëhet në formë shkresore dhe një kopje e skanuar i dërgohet edhe në rrugë elektronike autoritetit kompetent të destinacionit dhe autoritetit/eve të transitit.

11. Afati i shqyrtimit të dokumentacionit për dhënien e autorizimit, sipas pikës 7, të këtij vendimi, është 20 (njëzet) ditë pune nga data e marrjes së kërkesës. Ministria mund t’i kërkojë personit plotësim të dokumentacionit. Në këtë rast, afati për plotësimin e dokumentacionit nuk përllogaritet në afatin prej 20 (njëzet) ditësh pune. Afati mund të zgjatet deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë në varësi të marrjes së konfirmimeve nga autoritetet kompetente të destinacionit dhe/ose të transitit.

12. Ministri jep autorizimin për eksport të mbetjeve të rrezikshme për qëllim asgjësimi ose rikuperimi dhe të mbetjeve jo të rrezikshme që destinohen për qëllim asgjësimi, pasi të jetë marrë pëlqimi me shkrim nga autoriteti/et kompetent/e i destinacionit dhe/ose i transitit. Në rast se autoriteti kompetent i vendit të transitit nuk

përgjigjet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, ministri jep autorizimin.

13. Në rastin e eksportit të mbetjeve për qëllime asgjësimi, asgjësuesi njofton ministrinë për marrjen nga ana e tij në kohën e duhur të mbetjeve në fjalë për kryerjen e asgjësimit, siç specifikohet në dokumentin e njoftimit dhe dokumentet e lëvizjes, sipas anekseve 1 dhe 2, të këtij vendimi, për çdo transfertë. Në qoftë se ministria nuk merr njoftimin brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e daljes nga pika doganore e Republikës së Shqipërisë, njofton me shkrim autoritetin përkatës të vendit të importit.

14. Komunikimi midis ministrisë dhe autoriteteve kompetente të destinacionit dhe të transitit bëhet në gjuhë të pranueshme nga autoriteti kompetent i destinacionit. Në çdo rast, gjuha e përdorur është ajo angleze.

15. Përfshihen nga procedura e njoftimit dhe pranimit paraprak personat që kërkojnë të eksportojnë mbetje jo të rrezikshme për qëllim rikuperimi në sasi mbi 20 kg.

16. Për t’u pajisur me autorizim për eksportin e mbetjeve sipas përcaktimit në pikën 15, të këtij vendimi, personi përgatit dhe dorëzon në ministrinë përgjegjëse për mjedisin dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesën, në të cilën shprehen qartë: të dhënat personale (emri i personit fizik dhe/ose juridik); një përshkrim i mbetjeve që do të eksportohen ku të përcaktohen lloji dhe sasia e mbetjeve, vendi i origjinës së mbetjeve, vendi i importit dhe vendet e kalimit transit; mjetet e transportit të mbetjeve; mënyra e paketimit dhe/ose ambalazhimit dhe etiketimit të mbetjeve.

b) Kopjen e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) për objektin e veprimtarisë.

c) Kopjen e lejes së mjedisit të tipit A, B ose C, sipas përcaktimit në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.

ç) Kopjen e licencës III.2.B, sipas vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar.

d) Kopjen e noterizuar të përkthimit në gjuhën shqipe të kontratës së lidhur midis personit që eksporton dhe personit që merr në dorëzim mbetjet për menaxhimin e integruar të tyre.



dh) Formularin e plotësuar, sipas aneksit 3 bashkëlidhur këtij vendimi.

e) Kopjen e noterizuar të përkthimit në gjuhën shqipe të lejes/autorizimit/licencës lëshuar nga autoriteti kompetent i destinacionit që provon se personi që merr në dorëzim mbetjet ushtron ligjërisht në vendin e tij veprimtarinë për të cilën kryhet transferta, siç përcaktohet në kontratën midis palëve.

ë) Faturën e garancisë financiare apo sigurimit ekuivalent, sipas përcaktimit në pikën 20, të këtij vendimi.

f) Faturën (mandat-arkëtimi) që provon se ka paguar tarifën e shërbimit në llogarinë bankare të Ministrisë, në shumën 20 000 (njëzet mijë) lekë, e cila është e pakthyeshme.

17. Kontrata, sipas shkronjës “d”, të pikës 16, të këtij vendimi, e lidhur midis personit që eksporton mbetjet dhe personit që i merr në dorëzim mbetjet për rikuperimin, duhet të jetë efektive që nga aplikimi për autorizimin për eksport deri në përfundim të vlefshmërisë së autorizimit për të gjithë kohëzgjatjen e transfertave të mbetjeve.

18. Afati i shqyrtimit të dokumentacionit për dhënien e autorizimit, sipas pikës 16, të këtij vendimi, është 20 (njëzet) ditë pune nga data e marrjes së kërkesës. Ministria mund t'i kërkojë personit plotësim të dokumentacionit. Në këtë rast, afati për plotësimin e dokumentacionit nuk përlogaritet në afatin prej 20 (njëzet) ditësh.

19. Personi, që kërkon të pajiset me autorizim për eksport të mbetjeve, vendos një garanci financiare në një prej bankave në territorin e Republikës së Shqipërisë ose një sigurim ekuivalent në një prej kompanive të sigurimit që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë. Garancia financiare apo sigurimi ekuivalent është për llogari të ministrisë përgjegjëse për mjedisin për periudhën e vlefshmërisë së autorizimit për eksport.

20. Garancia financiare ka për qëllim të mbulojë shpenzimet që dalin në rastet kur një transfertë e mbetjeve nuk përfundon siç parashikohet në autorizimin për eksport apo në rastet kur sjell ndotje a dëmtim të mjedisit dhe/ose shëndetit të njerëzve gjatë eksportit nga vendi i daljes deri në vendin e destinacionit, duke mbuluar:

a) kostot e transportit;

b) kostot e rikuperimit ose asgjësimit, përfshirë çdo operacion të nevojshëm të përkohshëm;

c) kostot për ruajtjen e tyre për 90 (nëntëdhjetë) ditë.

21. Vlera e garancisë financiare ose sigurimit ekuivalent përlogaritet në bazë të vlerës së kontratës.

22. Për transfertat e mbetjeve që kanë për qëllim kryerjen e analizave laboratorike për të vlerësuar karakteristikat e tyre fizike ose kimike ose për të përcaktuar përshtatshmërinë e tyre për operacione rikuperimi ose asgjësimi, në një sasi deri në 25 kg, personi plotëson anekset 2 dhe 3 bashkëlidhur këtij vendimi dhe ia paraqet degës doganore të daljes.

23. Personi që eksporton mbetje ruan të dhënat për çdo ngarkesë që eksportohet:

a) 1 (një) vit nga data e përfundimit të afatit të autorizimit për eksportin e mbetjeve jo të rrezikshme për qëllim rikuperimi;

b) 3 (tre) vjet nga data e përfundimit të afatit të autorizimit për eksportin e mbetjeve të rrezikshme për qëllim asgjësimi ose rikuperimi dhe eksportin e mbetjeve jo të rrezikshme që destinohen për qëllim asgjësimi.

24. Të dhënat e ruajtura sipas pikës 23, të këtij vendimi, raportohen në ministri çdo 6 (gjashtë) muaj gjatë afatit të autorizimit. Këto të dhëna raportohen edhe në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe/ose Inspektoratin Shtetëror për Mjedisin, Pyjet dhe Ujërat me kërkesën e tyre me shkrim. Ministria krijon bazën e të dhënave për eksportin dhe transitin e mbetjeve.

25. Personi, që kërkon të pajiset me autorizim për kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, përgatit dhe dorëzon në ministrinë përgjegjëse për mjedisin dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesën, në të cilën shprehen qartë të dhënat personale dhe juridike të kërkuarit dhe bëhet një përshkrim i shkurtër i mbetjeve që do të transitojnë, ku të përcaktohen lloji, sasia, vendi ku e merr, pika kufitare e hyrjes dhe daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, shtetet nëpër të cilat do të kalojë, mjeti me të cilin do të transportojë mbetjet.

b) Kopjen e përkthyer dhe të noterizuar në gjuhën shqipe të kontratës së lidhur midis personit që eksporton dhe personit që merr në dorëzim mbetjet për menaxhimin e integruar të tyre.

c) Formularin e plotësuar, sipas aneksit 3 bashkëlidhur këtij vendimi.

ç) Faturën (mandat-arkëtimi) që provon se ka



paguar tarifën e shërbimit në llogarinë bankare të Ministrisë, në shumën 20 000 (njëzet mijë) lekë, e cila është e pakthyeshme.

26. Afati për shqyrtimin e kërkesës dhe dokumentacionit për kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte është 30 (tridhjetë) ditë kalendarike.

27. Formulari në aneksin 2 bashkëlidhur këtij vendimi plotësohet për çdo transfertë të kryer nga personi që:

a) është pajisur me autorizim për eksportin e mbetjeve;

b) është pajisur me autorizim për kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme ose mbetjeve inerte.

28. Një kopje (e skanuar) e formularit, sipas aneksit 2 bashkëlidhur këtij vendimi, dërgohet për çdo transfertë në rrugë elektronike në adresën zyrtare në ministrinë përgjegjëse për mjedisin brenda 5 (pesë) ditëve pune:

a) nga dega doganore e daljes, për eksportin e mbetjeve;

b) nga dega doganore e hyrjes dhe nga dega doganore e daljes, për kalimin transit të mbetjeve.

29. Autorizimi është i vlefshëm për një afat kohor deri në 1 (një) vit nga data e lëshimit për:

a) eksportin e mbetjeve;

b) transitimin e mbetjeve jo të rrezikshme apo mbetjeve inerte.

30. Në raste të refuzimit të kërkesës për pajisje me autorizimin për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme apo mbetjeve inerte, personi mund të ankohet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

31. Ministria përgjegjëse për mjedisin mban regjister të veçantë për kërkesat për autorizim për eksport të mbetjeve apo kalimin transit të mbetjeve

jo të rrezikshme apo inerte. Format i regjistrit e mënyra e administrimit të tij miratohen me urdhër të ministrit. Ministri miraton me urdhër modelin e autorizimit për eksport të mbetjeve apo kalimit transit të mbetjeve jo të rrezikshme apo inerte.

32. Çdo autorizim mban një kod të veçantë shifror i cili fillon me siglën AL. Kodi është i ndryshëm për çdo autorizim të dhënë, fillon të rinumërohet çdo fillim viti kalendarik dhe nuk përsëritet. Kodi përbëhet nga 3 (tre) numra dhe viti kur lëshohet autorizimi i ministrit, sipas modelit në aneksin 4 bashkëlidhur këtij vendimi.

33. Tarifatat që paguhen në zbatim të këtij vendimi derdhen në buxhetin e shtetit.

34. Mosrespektimi i kushteve dhe kërkesave të parashikuara në këtë vendim kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative, siç parashikohet në nenin 62, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

35. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, rregullorja e ministrit të Mjedisit nr. 4, datë 15.10.2003, “Për kerkimin, shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të eksportimit dhe të kalimit transit të mbetjeve”, shfuqizohet.

36. Ngarkohen ministria përgjegjëse për mjedisin, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, degët doganore, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Inspektorati Shtetëror për Mjedisin, Pyjet dhe Ujërat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI1

Dokumenti i njoftimit paraprak për transferat/lëvizje ndërkufitare të mbetjeve

1. Regjistrimi i Eksportuesit – njoftuesit Numri: Emri: Adresa: Personi i kontaktit: Tel:Fax: E-mail:	3. Njoftimi Nr: Njoftim për: A.(i) Transfertë të vetme:(ii) trans ☐ ta të shumëfishta: ☐ B. (i) Asgjësim (i):(ii) Rikuperim ☐ ☐ C. Impianti i rikuperimit i miratuar paraprakisht: ☐ (2;3)PoJo ☐
2.Importuesi – marrësi në dorëzim	4. Numri total i transfertave të synuara:



Numri i regjistrimit: Emri: Adresa: Personi i kontaktit: Tel:Fax: E-mail:		5. Sasia totale e synuar (4): Ton (Mg): m ³ :		
		6. Periudha e kohës së synuar për transfert/ën/at (4): Nisja e parë:Nisja e fundit:		
		7. Lloj/i/et e paketimit/ambalazhimit (5): Kërkesa të veçanta për kujdes gjatë transferimit: (6):Po: Jo:		
8. Transportuesit e pritshëm Numri i regjistrimit: Emri (7): Adresa: Personi i kontaktit: Tel:Fax: E-mail: Mjeti i transportit (5):		11. Operacionet e Rikuperimit (2) D-code / R-code (5) : Teknologjia që përdoret (6): Arsytet për eksport (1,6):		
9. Gjeneruesi/t e mbetjeve - prodhuesi/t(1;7;8) Numri i regjistrimit: Emri: Adresa: Personi i kontaktit: Tel:Fax: E-mail: Sheshi dhe procesi i gjenerimit (6):		12. Emri dhe përbërja e mbetjes (6):		
10. Impiant asgjësimi(2): ☐ apo Impiant rikuperimi (2): ☐ Numri i regjistrimit: Emri: Adresa: Personi i kontaktit: Tel:Fax: E-mail: Sheshi aktual i asgjësimit/ rikuperimit:		13. Karakteristika fizike (5):		
		14. Identifikimi i mbetjes (plotësoni kodet e dubur) (i) Aneksi VIII (ose IX nëse ka kuptim) i Bazelit (ii) Kodi i OECD (nëse i ndryshëm nga (i)): (iii) Lista e mbetjeve e Komisionit Evropian: (iv) Kodi nacional në vendin e eksportit: (v) Kodi nacional në vendin e importit: (vi) Të tjera (specifikoni): (vii) Kodi Y: (viii) Kodi H (5): (ix) Klasa e BE-së (5): (x) Numri i BE-së: (xi) Emri i transfertës së BE-së: (xii) Kod/i/et e doganave (HS):		
15. (a) Vendet/shtetet e interesuara (b) Nr. i kodit të autoritetit kompetent aty ku është e aplikueshme (c) Pikat e veçanta të daljes apo të hyrjes (kufijtëapo portet ku kalon)				
Shteti eksportues – nga ku bëhet dalje	Shtet/i/et e kalimit transit (të hyrjes dhe daljes)			Shteti importues – destinacioni
a)				
b)				
c)				
16. Zyrat e doganave të hyrjes dhe /ose daljes dhe/ose të eksportit (Komuniteti European):				
Hyrja: Dalja: Eksporti:				
17. Deklarata e Eksportuesit – njoftuesit – gjeneruesit – prodhuesit (1): Vërtetohet se në dijeninë time informacioni është i plotë dhe korrekt. Gjithashtu vërtetohet se janë shënuar detyrimet kontraktuale të shkruara ligjore dhe të detyrueshme dhe çdo siguracion apo garanci financiare që është ose do të jetë në fuqinë lidhje me lëvizjen ndërkufitare. Emri i eksportuesit – njoftuesit: Data:Firma: Emri i gjeneruesit – prodhuesit:Data:Firma:				
18. Numri i anekseve të bashkangjitura:				
PËR PËRDORIM NGA AUTORITETET KOMPETENTE				



19. Njohja nga autoriteti kompetent respektiv i vendeve të importit – të destinacionit/ transitit (1)/ eksportit – të daljes (9): Emri i vendit: Njoftimi i marrë më datë: Njohja e njoftimit dërguar më datë: Emri i autoritetit kompetent: Vula dhe/apo firma:	20. Miratimi me shkrim (1,8) për lëvizjen nga autoriteti kompetent (emri i vendit): Miratimi dhënë më datë: Miratimi i vlefshëm nga data: Deri më datë: Kushte speciale: Jo: Në ☐ Po, shih bllokun 21 ☐ (6): Emri i autoritetit kompetent: Vula dhe/apo firma:
21. Kushte specifike për lejimin e lëvizjes apo arsyt për kundërshtimin e saj (1) Kërket nga Konventa e Bazelit (2) Në rastin e një operacioni R12/R13 apo D13-D15, bashkëngjiti edhe informacionin korrespondues mbi çdo impant pasues R12/R13 apo D13-D15 dhe për impant/in/etpasese R1-R11 apo D1-D12 nëse kërkohen/janë të nevojshme. (3) Të plotësohen për lëvizjet brenda zonës së vendeve të OECD dhe vetëm nëse aplikohet pika B(ii) (4) Bashkëngjiti listën e detajuar në rastin kur bëhet fjalë për transferat të shumëfishta (5) Shih listën e shkurtimeve dhe kodeve në faqen tjetër (6) Bashkëngjiti detaje nëse është e nevojshme (7) Bashkëngjiti listën nëse ka më shumë se një (8) Në rastin kur kërkohet nga legjislacioni kombëtar (9) Nëse është e aplikueshme në Vendimin e OECD	

Lista e shkurtimeve dhe kodeve të përdorur në dokumentin e njoftimit

OPERACIONET E ASGJËSIMIT (blloku 11) D1 Depozitimi mbi, në dhe nën tokë (p.sh. landfill etj.) D2 Trajtimi i tokës (p.sh. biodegradimi i lëngjeve apo llucërave të shkarkuara nëtokë etj.) D3 Injektim i thellë (p.sh. injektim me pompim të mbetjeve të lëngshme brenda puseve, në minierat e shfrytëzuara të kripës apo vendgrumbullimet e mundshme natyrore etj.) D4 Depozitim sipërfaqësor (p.sh. vendosja e lëngjeve apo llucërave të shkarkuara në gropa, pellgje ujore apo laguna etj.) D5 Landfill me disenjim inxhinjrik të veçantë (p.sh. vendosja në qeliza me shtresë dhe mbulesë të izoluar nga njëra tjetra dhe nga mjedisi etj.) D6 Shkarkimi në një trup ujq përveç deteve/oqeanëve D7 Shkarkimi në dete/oqeanë përfshirë futjen në shtratin e tyre D8 Trajtimi biologjik i papërmendur në asnjë vend tjetër në këtë listë, i cili rezulton në përzjerje apo përbërje përfundimtare që shkarkohen përmes çdonjërit nga operacionet e kësaj liste D9 Trajtimi fiziko-kimik i papërmendur në asnjë vend tjetër në këtë listë, i cili rezulton në përzjerje apo përbërje përfundimtare që shkarkohen përmes çdonjërit nga operacionet e kësaj liste (p.sh. avullim, tharje, kalcifikim etj.) D10 Incinerim/djegje mbi tokë D11 Incinerim/djegje në det D12 Ruajtje e përhershme (p.sh. vendosje e kontejnerëve në një minierë etj.) D13 Grirje apo përzjerje para dorëzimit për trajtim në çdonjërin nga operacionet e kësaj liste D14 Ri-paketim/ambalazhim para dorëzimit për trajtim në çdonjërin nga operacionet e kësaj liste D15 Ruajtje në pritje për t'u përdorur në çdonjërin nga operacionet e numëruara në këtë listë.	
OPERACIONET E RIKUPERIMIT (blloku 11) R1 Përdoret si lëndë djegëse (përveç rastit të djegies së drejtpërdrejtë) ose mjete të tjera për prodhim energjie (Basel/OECD) - Përdoret kryesisht si lëndë djegëse apo mjet tjetër që gjeneron energji (BE) R2 Rikuperim/rigjenerim i solventëve R3 Riciklim/rikuperim i substancave organike që nuk janë përdorur si solventë R4 Riciklim/rikuperim i metaleve dhe komponimeve metalike R5 Riciklim/rikuperim i materialeve të tjera inorganike R6 Rigjenerim i acideve apo bazave R7 Rikuperim i komponentëve të përdorur për luftimin e ndotjes R8 Rikuperim i komponentëve prej katalizatorëve R9 Ri-rafinim i vajit të përdorur apo përdorime të tjera të vajrave të përdorur më parë R10 Trajtim i tokës që sjell përfitime në bujqësi apo përmirësime ekologjike R11 Përdorime të materialeve mbeturinë që merren nga çdo operacion që ka numrat R1-R10 R12 Shkëmbim i mbetjeve për dorëzim të çdonjërit prej operacioneve që kanë numrat R1-R11 R13 Akumulim i materialeve që synohen për secilin operacion në këtë listë.	
TIPAT E PAKETIMIT (blloku 7) 1. Fuçi hekuri/tambur 2. Fuçi druri 3. Bidon 4. Kuti 5. Thasë 6. Paketim i përzjer/ ambalazhe të ndryshme 7. Enë nën presion 8. Voluminoz 9. Të tjera (specifiko)	KODI H DHE KLASA E BE-së (blloku 14) Klasa e BE-se Kodi H Karakteristika 1H1Eksplodive 3H3Lëngje të përfllakshme 4.1 H4.1 Lëndë të ngurta të përfllakshme 4.2 H4.2 Substanca apo mbetje që mund të digjen spontanisht 4.3 H4.3 Substanca apo mbetje që në kontakt me ujin, emetojnë gaze të



MJETET E TRANSPORTIT (blloku 8) R = Rugor T = Hekurudhor S = Detar A = Ajror Ë = Lumor	përflakshme 5.1H5.1 Oksiduese 5.2H5.2 Perokside organike 6.1H6.1 Helmuese (akute) 6.2H6.2 Substanca infektuese 8 H8 Korrozive 9 H10 Çlirim i gazeve toksike në kontakt me ajrin apo ujin 9 H11 Toksike (të vonuara apo kronike) 9 H12 Ekotoksike 9 H13 Të mundshme në çdo rast, pas asgjësimit të një materiali tjetër, p.sh. lëngjet që kanë ndonjë nga karakteristikat e mësipërme.
KARAKTERISTIKA FIZIKE (blloku 13) 1. Në gjendje pluhuri/pudre 2. Në gjendje të ngurtë 3. Në gjendje viskoze/brumi 4. Në gjendje llumi/balte 5. Në gjendje të lëngshme 6. Në gjendje të gaztë 7. Të tjera (specifikoni)	

Informacion i mëtejshëm, në veçanti në lidhje me identifikimin e mbetjes (blloku 14), domethënë për kodet e anekseve VIII dhe IX të Bazelit, të OECD-së dhe kodet Y, mund të gjendet në një Manual Udhëzues që mund të sigurohet përmes OECD-së dhe Sekretariatit të Konventës së Bazelit.

ANEKSI 2

Dokumenti i lëvizjes për lëvizjet/transfertat ndërkufitare të mbetjeve

1. Korrespondon me njoftimin nr.		2. Numri i serisë/total i transfertave	
3. Regjistrimi i eksportuesit – njoftuesit		4. Importuesi – marrësi në dorëzim	
Nr. :		Nr. i regjistrimit:	
Emri:		Emri:	
Adresa:		Adresa:	
Personi i Kontaktit:		Personi i Kontaktit:	
Tel:Fax:		Tel: Fax:	
E-mail:		E-mail:	
5. Sasia aktuale: Ton : m ³ (Mg):		6. Data aktuale e transfertës:	
7. Ambalazhi/paketimi Tip/i/et (1): Numri i pakove: ☐ ☐			
Kërkesa specifike për përkujdesje gjatë transportit: (2) Po: ☐ Jo: ☐			
8.(a) Ngarkesa e 1rë (3): Nr. i regjistrimit:	8.(b) Ngarkesa e 2të: Nr. i regjistrimit:	8.(c) Ngarkesa e fundit: Nr. i regjistrimit:	
Emri:	Emri:	Emri:	
Adresa:	Adresa:	Adresa:	
Personi i Kontaktit:	Personi i Kontaktit:	Personi i Kontaktit:	
Tel: Fax:	Tel: Fax:	Tel: Fax:	
E-mail:	E-mail:	E-mail:	
----- Për t'u plotësuar nga përfaqësuesi ingarkesës ----- Mbi 3 ngarkesa			
(2)			
Mjetet e transportit (1):	Mjetet e transportit (1):	Mjetet e transportit (1):	
Data e transfertës:	Data e transfertës:	Data e transfertës:	
Firma:	Firma:	Firma:	
9. Gjenerues/i/t – prodhues/i/it e mbetjes (4;5;6) Nr. i regjistrimit: Emri: Adresa:		12. Emri dhe përbërja e mbetjes (2):	
Personi i Kontaktit: Tel: Fax: E-mail: Sheshi i gjenerimit (2)		13. Karakteristika fizike (1):	



10. Impiant asgjësimi: ☐ apo impiant rikuperimi: ☐ Nr. i regjistrimit: Emri: Adresa: Personi i Kontaktit: Tel: Fax: E-mail: Sheshi aktual i asgjësimit/rikuperimit (2)	14. Identifikimi i mbetjes (<i>plotëso kodet e dubura</i>) (i) Aneksi VIII (ose IX nëse ka kuptim) i Bazelit (ii) Kodi i OECD (nëse i ndryshëm nga (i)): (iii) Lista e mbetjeve e Komisionit Evropian: (iv) Kodi nacional në vendin e eksportit: (v) Kodi nacional në vendin e importit: (vi) Të tjera (specifiko): (vii) Kodi Y: (viii) Kodi H (1): (ix) Klasa e BE-së (1): (x) Numri i BE-së: (xi) Emri i transfertës së BE-së (xii) Kodet e doganave (HS):
11. Operacion/i/et e asgjësimit/rikuperimit D-code / R-code (1)	
15. Deklarata e Eksportuesit – njoftuesit – gjeneruesit – prodhuesit (4): Vërtetohet se në dijeninë time informacioni është i plotë dhe korrekt. Gjithashtu vërtetohet se janë shënuar detyrimet kontraktuale të shkruara ligjore dhe të detyrueshme dhe çdo siguracion apo garanci financiare që është ose do të jetë në fuqinë e lidhje me lëvizjen ndërkufitare. Emri: Data: Firma:	
16. Për t'u përdorur nga personi i angazhuar në lëvizjen ndërkufitare në qoftë se kërkohet informacion suplementar	
17. Ngarkesa u mor në dorëzim nga importuesi/marrësi Data: Emri: Firma: (në rast se importuesi nuk është përdoruesi/impianiti):	
PËR T'U PLOTËSUAR NGA IMPIANTI I ASGJËSIMIT/RIKUPERIMIT	
18. Ngarkesa u mor në dorëzim nga impianti i asgjësimit ☐ apo impianti i rikuperimit ☐ Data e marrjes në dorëzim: Pranuar: Refuzuar *: ☐ Sasia e marrë: Tonn ☐ <i>kontakti menjëherë autoritetet</i> (Mg): <i>kompetente</i> Data e përafërt e asgjësimit/rikuperimit: Operacioni i asgjësimit/rikuperimit (1): Emri: Data: Firma:	19. Vërtetohet se asgjësimi/rikuperimi i mbetjeve të përshkruara me lart është përfunduar. Emri: Data: Firma dhe vula:

(1) Shih listën e shkurtimeve dhe kodeve në faqen tjetër.

(2) Bashkëngjitni detaje nëse është e nevojshme.

(3) Në qoftë se janë më shumë se 3 ngarkesa, bashkëngjitni informacionin që kërkohet në blloqet 8 (a,b,c).

(4) Kërkohet nga Konventa e Bazelit.

(5) Bashkëngjitni listën në qoftë se ka më shumë se një.

(6) Në qoftë se kërkohet nga legjislacioni vendas.

PËR PËRDORIM NGA ZYRAT E DOGANAVE (nëse kërkohet nga legjislacioni vendas)			
20. Vendi i eksportit – zyra e doganës së daljes – dispecerisë Mbetja e përshkruar në këtë dokument lëvizje u largua nga vendi me datë: Firma: Vula:		21. Vendi i importit – zyra e doganës së vendit të destinacionit ose të hyrjes Mbetja e përshkruar në këtë dokument lëvizje hyri në vend me datë: Firma: Vula:	
22. Vulat e zyrave të doganave të vendeve të kalimit transit			
Emri i vendit: Hyrja: Dalja:		Emri i vendit: Hyrja: Dalja:	
Emri i vendit: Hyrja: Dalja:		Emri i vendit: Hyrja: Dalja:	



Lista e shkurtimeve dhe kodeve të përdorura në dokumentin e lëvizjes

OPERACIONET E ASGJËSIMIT (blloku 11) D1 Depozitimi mbi, në dhe nën tokë (p.sh. landfill etj.) D2 Trajtimi i tokës (p.sh. biodegradimi i lëngjeve apo llucërave të shkarkuara në tokë etj.) D3 Injektim i thellë (p.sh. injektim me pompim të mbetjeve të lëngshme brenda puseve, në minierat e shfrytëzuara të kripës apo vendgrumbullimet e mundshme natyrore etj.) D4 Depozitim sipërfaqësor (p.sh. vendosja e lëngjeve apo llucërave të shkarkuara në gropa, pellgje ujore apo laguna etj.) D5 Landfill me disenjim inxhinierik të veçantë (p.sh. vendosja në qeliza me shtresë dhe mbulesë të izoluar nga njëra tjetra dhe nga mjedisi etj.) D6 Shkarkimi në një trup ujqor përveç deteve/oqeanëve D7 Shkarkimi në dete/oqeanë përfshirë futjen në shtratin e tyre D8 Trajtimi biologjik i papërmendur në asnjë vend tjetër në këtë listë, i cili rezultoi në përzierje apo përbërje përfundimtare që shkarkohen përmes çdonjërit nga operacionet e kësaj liste D9 Trajtimi fiziko-kimik i papërmendur në asnjë vend tjetër në këtë listë, i cili rezultoi në përzierje apo përbërje përfundimtare që shkarkohen përmes çdonjërit nga operacionet e kësaj liste (p.sh. avullim, tharje, kalcifikim etj.) D10 Incinerim/djegje mbi tokë D11 Incinerim/djegje në det D12 Ruajtje e përhershme (p.sh. vendosje e kontejnerëve në një minierë etj.) D13 Grirje apo përzierje para dorëzimit për trajtim në çdonjërin nga operacionet e kësaj liste D14 Ri-paketim/ambalazhim para dorëzimit për trajtim në çdonjërin nga operacionet e kësaj liste D15 Ruajtje në pritje për t'u përdorur në çdonjërin nga operacionet e numëruara në këtë listë.	OPERACIONET E RIKUPERIMIT (blloku 11) R1 Përdoret si lëndë djegëse (përveç rastit të djegies së drejtpërdrejtë) ose mjete të tjera për prodhim energjie (Basel/OECD) - Përdoret kryesisht si lëndë djegëse apo mjet tjetër që gjeneron energji (BE) R2 Rikuperim/rigjenerim i solventëve R3 Riciklim/rikuperim i substancave organike që nuk janë përdorur si solvente R4 Riciklim/rikuperim i metaleve dhe komponimeve metalike R5 Riciklim/rikuperim i materialeve të tjera inorganike R6 Rigjenerim i acideve apo bazave R7 Rikuperim i komponentëve të përdorur për luftimin e ndotjes R8 Rikuperim i komponentëve prej katalizatorëve R9 Ri-rafinim i vajit të përdorur apo përdorime të tjera të vajrave të përdorur me parë R10 Trajtim i tokës që sjell përfitime në bujqësi apo përmirësime ekologjike R11 Përdorime të materialeve mbeturinë që merren nga çdo operacion që ka numrat R1-R10 R12 Shkëmbim i mbetjeve për dorëzim të çdonjërit prej operacioneve që kanë numrat R1-R11 R13 Akumulim i materialeve që synohen për secilin operacion në këtë listë.
TIPAT E PAKETIMIT (blloku 7) 1. Fuçi hekuri/tambur 2. Fuçi druri 3. Bidon metalik 4. Kuti 5. Thasë 6. Paketim i përzier/ ambalazhe të ndryshme 7. Enë nën presion 8. Voluminoz 9. Të tjera (specifiko)	KODI H DHE KLASA E BE-së (blloku 14) Klasa e BE-së Kodi H Karakteristika 1H1Eksplodive 3H3Lëngje të përfllakshme 4.1 H4.1 Lëndë të ngurta të përfllakshme 4.2 H4.2 Substanca apo mbetje që mund të digjen spontanisht 4.3H4.3 Substanca apo mbetje që në kontakt me ujin, emetojnë gaze të përfllakshme 5.1H5.1 Oksiduese 5.2H5.2 Perokside organike 6.1H6.1 Helmuese (akute) 6.2H6.2 Substanca infektuese 8 H8 Korrozive 9 H10Çlirim i gazeve toksike në kontakt me ajrin apo ujin 9 H11 Toksike (të vonuara apo kronike) 9 H12 Ekotoksike 9 H13 Të mundshme në çdo rast, pas asgjësimit të një materiali tjetër, p.sh. Lëngjet që kanë ndonjë nga karakteristikat e mësipërme.
MJETET E TRANSPORTIT (blloku 8) R = Rrugor T = Hekurdhor S = Detar A = Ajror Ë = Lumor	
KARAKTERISTIKA FIZIKE (blloku 13) 1. Në gjendje pluhuri/pudre 2. Në gjendje të ngurtë 3. Në gjendje viskoze/brumi 4. Në gjendje llumi/baltë 5. Në gjendje të lëngshme 6. Në gjendje të gaztë 7. Të tjera (specifikoni)	

Informacion i mëtejshëm, në veçanti në lidhje me identifikimin e mbetjes (blloku 14), domethënë për kodet e anekseve VIII dhe IX të Bazelit, të OECD-së dhe kodet Y, mund të gjendet në një Manual Udhëzues që mund të sigurohet përmes OECD-së dhe Sekretariatit të Konventës së Bazelit.

1. Personi që organizon transfertën 2. Emri: 3. Adresa 4. Personi i kontaktit 5. Tel: Fax:	2. Importuesi-marrësi në dorëzim Numri i regjistrimit: Emri: Adresa: Personi i kontaktit:
--	---

ANEKSI 3

Informacioni që shoqëron eksportin e mbetjeve jo të rrezikshme për qëllim rikuperimi në sasi mbi 20 kg; transfertat e mbetjeve që kanë për qëllim kryerjen e analizave laboratorike për të vlerësuar karakteristikat e tyre fizike ose kimike ose për të përcaktuar përshtatshmërinë e tyre për operacione rikuperimi ose asgjësimi, në një sasi deri në 25 kg.



E-mail		Tel:		Fax:	
3.Sasia aktuale: kg: Litër:		E-mail:			
4.Data aktuale e transfertës:					
5.(a) (i) Ngarkesa e 1-rë: Nr. i regjistrimit: Emri: Adresa: Tel: Fax: E-mail: Mjetet e transportit: Data e transfertës: Firma:		5.(b) Ngarkesa e 2-të: Nr. i regjistrimit: Emri: Adresa: Tel: Fax: E-mail: Mjetet e transportit: Data e transfertës: Firma:		5.(c) Ngarkesa e 3-të : Nr. i regjistrimit: Emri: Adresa: Tel: Fax: E-mail: Mjetet e transportit : Data e transfertës: Firma:	
6. Gjenerues/i/t - e mbetjes(?) Prodhues/i/t original, prodhues/i/t e rinj ose grumbulluesit Emri: Adresa: Personi i kontaktit: Tel: Fax: E-mail:		8. Operacioni rikuperimit (ose nëse është e përshtatshme operacioni asgjësimit në rastin e mbetjeve refereaur në Nenin 3(4): D-code / R-code (1)			
7. Impiant rikuperimi : ☐ Laboratori ☐ Emri: Adresa: Personi i kontaktit: Tel: Fax: E-mail:		9. Përshkrimi i zakonshëm i mbetjes: 14. Identifikimi i mbetjes (plotësoni kodet e duhura) i) Aneksi VIII (ose IX nëse ka kuptim) i Bazelit ii) Kodi i OECD (nëse i ndryshëm nga (i)): iii) Lista e mbetjeve e Komisionit Evropian: iv) Kodi nacional:			
11. Vendet/shtetet e interesuara:					
Shteti eksportues/dalja		Shteti/et e kalimit tranzit		Shteti importues /destinacioni	
12. Deklarata e personit që organizon transfertën: Vërtetohet se në vijën e mëposhtme informacioni është i plotë dhe korrekt. Gjithashtu, vërtetohet se marrësit në dorëzim janë shënuar detyrimet kontraktuale të shkruara ligjore dhe të detyrueshme (nuk kërkohet në rastet e mbetjeve referuar në Nenin 3 (4)):					
Emri:		Data:		Firma:	
13. Nënshkrimi pasi merret konfirmimi i mbetjeve nga marrësi:					
Emri:		Data:		Firma:	
TË PLOTËSOHET NGA IMPIANTIT RIKUPERIMIT OSE NGA LABORATORI					
14. Transferta a marrë në impiantin e rikuperimi ☐ ose laboratorit ☐ Sasia e marrë kg: litër:					
Emri:		Data:		Firma:	

Informacioni marrjes në dorëzim

(1) Nëse ka më shumë se tre ngarkesa siç kërkohet në blloqet 5(a) (b) dhe (c).

(2) Kur personi që organizon transfertën nuk është prodhuesi ose grumbulluesi duhet të sigurohet informacion për prodhuesin.

ANEKSI 4

Kodi shifror i cili shoqëron çdo autorizim fillon me siglën AL pasohet nga 3 numra, fraksion dhe viti kalendarik kur lëshohet autorizimi.

P.sh Për autorizimin e parë që lëshohet për vitin 2015 numërimi fillon me AL001/2015 dhe vijon në rend rritës për të njëjtin vit kalendarik: AL002/2015; AL003/2015e kështu me radhë.

VENDIM

Nr. 644, datë 1.10.2014

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRJETIT KRYESOR TË KANALIZIMEVE DHE IMPIANTIT TË PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË PËRDORURA NË PLAZHIN E VELIPOJËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen

në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrjetit kryesor të kanalizimeve dhe impiantit të përpunimit të ujërave të përdorura në plazhin e Velipojës.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve.



3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë pemëtoje, me sipërfaqe prej 17 870 (shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) m², me vlerë të përgjithshme prej 4 681 940 (katër milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 309 000 (treqind e nëntë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 4 681 940 (katër milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2014, zëri “Investime”, i planifikuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 5, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7 të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjetllës - Kanalizimeve, të fillojnë procedurat për hedhjen e projektit të objektit në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve, dhe me fillimin e procesit të likuidimit të fillojë dhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së projektit të objektit në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
SEKTORI I SHPRONËSIMIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE
DREJTORIA E PROJEKTEVE IPA

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I IMPIANTIT TË
UJËRAVE TË PËRDORURA PËR ZONAT E VELIPOJËS

FSHATI “PULAJ” ZK.3072, SHKODËR

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kadastr.	Numri i pasurisë	Sip. totale	Sipërfaqja (m ²)	TOKË pemëtoje		Vlera totale (lekë)	Shënime
								çmimi (leke/m ²)	vlera (lekë)		
1	Emiljan	Nik	Nika	3072	966/7	8,050	8050	262	2109100	2109100	Konfirmim ZVRPP
2	Luigj	Dede	Suka	3072	966/5	9,820	9820	262	2572840	2572840	Konfirmim ZVRPP
3	SHUMA						17870			4681940	



VENDIM

Nr. 645, datë 1.10.2014

**PËR NGRITJEN DHE MËNYRËN E
FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË
ÇMIMIT TË BARNAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 38, të ligjit nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, me propozimin e ministrit të Financave dhe ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit të Çmimit të Barnave, si njësi e përhershme, pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

2. Komisioni i Çmimit të Barnave të kryesohet nga sekretari i përgjithshëm i ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe të ketë në përbërje:

a) Një përfaqësues nga Drejtoria Farmaceutike, pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë;

b) Një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat;

c) Një përfaqësues nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;

ç) Një përfaqësues nga Agjencia Kombëtare për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore.

Sekretari i komisionit është një specialist i Drejtorisë Farmaceutike pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

Titullarët e institucioneve, të përmendura në këtë pikë, caktojnë në detyrën e anëtarit të komisionit punonjës që kanë lidhje me funksionin dhe detyrat e këtij komisioni.

3. Mbajtësit e autorizimit të tregtimit të barit në Shqipëri, brenda datës 31 tetor të çdo viti, deklarojnë me shkresë, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi, në zarf të mbyllur, pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, çmimet “CIF” në euro ose dollarë, për barnat e importit dhe çmimet “EXW” (*ex-work*) në lekë, për barnat e fabrikuara në vend. Dorëzimi i çdo zarfi të mbyllur me deklarin e çmimeve bëhet në protokollin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe shoqërohet me nënshkrimin e personit të autorizuar nga kompania për këtë veprim dhe të punonjësit të protokollit, i cili pranon dokumentacionin. Çdo zarf i ardhur në ministri regjistrohet në një regjistër të veçantë, me numrin rendor përkatës dhe datën e marrjes së tij në dorëzim.

4. Deklarimi i çmimit duhet të bëhet sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi. Ai duhet të jetë origjinal, i firmosur dhe i vulosur nga mbajtësi i autorizimit për tregtim. Në rast të kundërt, deklarimi do të quhet i pavlefshëm dhe nuk do të merret në shqyrtim nga komisioni.

5. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë njofton, nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare, të gjithë mbajtësit e autorizimit të tregtimit të barit në Shqipëri, për deklarin e çmimeve “CIF” në euro ose dollarë, për barnat e importit dhe çmimet “EXW” (*ex-work*) në lekë, për barnat e fabrikuara në vend, pranë saj, brenda datës 30 shtator.

6. Komisioni i Çmimit të Barnave, brenda datës 5 nëntor të çdo viti, mbledhet, me njoftim të kryetarit, për hapjen e zarfeve të çmimeve të deklaruara, të cilat siglohen nga anëtarët e pranishëm në komision.

7. Mbledhjet e Komisionit të Çmimit të Barnave janë të vlefshme kur në to janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Miratimi i çmimeve të barnave bëhet me votim të hapur dhe vendimi merret me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Në rast se ka barazim votash, vota e kryetarit është vendimtare.

8. Komisioni i Çmimit të Barnave, kur është e nevojshme, mbledhet me njoftim të kryetarit për të miratuar çmimet e deklaruara për barnat që regjistrohen gjatë vitit kalendarik pasardhës. Në këto raste, miratimi i çmimit të barnave bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas depozitimit të deklarin të tyre pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

9. Çmimet “CIF”, të deklaruara në Shqipëri, do të krahasohen me çmimet e tregtimit me shumicë të shteteve referente: Itali, Greqi, Serbi, Maqedoni dhe Kroaci. Në rastet kur mungon informacioni për çmimet e tregtimit me shumicë nga shtetet referente, krahasimi do të bëhet me çmimet e shitjes me pakicë të barit.

10. Komisioni i Çmimit të Barnave verifikon edhe çmimet e deklaruara të tregtimit me pakicë të barit në vendin e origjinës, në formularin e deklarin të çmimit nga mbajtësi i autorizimit të tregtimit. Në rast se të dhënat e deklaruara nga mbajtësi i autorizimit për tregtim mbi çmimin e shitjes me pakicë të barit në vendin e origjinës janë të ndryshme, komisioni merr vendim që barit të mos i miratohet çmimi për vitin pasardhës.



11. Komisioni i Çmimit të Barnave verifikon edhe dokumentacionin e importeve të barnave, të kryera dhe të depozituara pranë Agjencisë Kombëtare për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore, gjatë 12 muajve të fundit.

12. “Çmimi i referencës për Shqipërinë” do të jetë çmimi më i ulët nga elementet e mëposhtme:

a) çmimi që aplikohet ndër pesë shtetet referente;

b) çmimi i tregtimit me pakicë të barit në vendin e origjinës;

c) çmimi i barnave të importuara në Republikën e Shqipërisë, gjatë 12 muajve të fundit.

13. Çmimi i barit gjenerik duhet të jetë deri në 80% të çmimit të barit origjinator, të regjistruar pranë Agjencisë. Nëse bari origjinator nuk është i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, atëherë do të merret për bazë çmimi i tij në vendet e referencës dhe të origjinës.

14. Çmimi i shitjes me pakicë të barit në Republikën e Shqipërisë duhet të jetë më i ulët ose i njëjtë me çmimin e shitjes me pakicë të tij në vendin e origjinës.

15. Barnat, për të cilat nuk është deklaruar çmim, ose të cilat nuk janë regjistruar/reregjistruar deri më 31 tetor të vitit aktual, humbasin të drejtën për t'u futur në listën e barnave të rimbursuara për vitin pasardhës.

16. Informacioni për krahasimin e çmimeve të barnave do të merret nga botimet zyrtare, të publikuara nga institucionet homologe në vendet e referencës.

17. Drejtoria Farmaceutike, në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, brenda datës 31 dhjetor të çdo viti, bën shpalljen, në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, e listës së përgjithshme me çmimet “CIF/EXW”, të miratuar nga Komisioni. Kjo listë dërgohet zyrtarisht tek Agjencia Kombëtare për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

18. Kundër vendimit të Komisionit të Çmimit të Barnave bëhet ankim sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative.

19. Anëtarët dhe sekretari i komisionit shpërblehen për çdo mbledhje, sipas përcaktimeve të bëra në vendimin nr. 418/2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblyerimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

20. Vendimi nr. 62, datë 1.2.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e funksionimit të Komisionit të Çmimit të Barnave”, të ndryshuar, shfuqizohet.

21. Ngarkohen ministria përgjegjëse për shëndetësinë, ministria përgjegjëse për financat dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



REPUBLIC OF ALBANIA
MINISTRY OF HEALTH
PHARMACEUTICAL DEPARTMENT

Formulari i deklarimit të çmimeve CIF të barnave
(Declaration form of CIF price for medicinal products for human use)

Nr. (No)	Emri tregtar (Trade name)	Formë-doza (Dosage-form)	Principi aktiv (Active ingredient)	Paketimi (Package)	Mbajtësi i autorizimit të tregtimit (Marketing authorizing holder)	Prodhuksi (Manufacturer)	Urdhri i regjistrimit (Registration order)	Çmimi CIF (CIF price)	Çmimi pakicës në vendin e origjinës (Retail price in origin country)
1	XXXX	XXXXX	XXXXXX	XXXXX	XXXXXX	XXXXXX	Nr./datë (No./date)	X monedha/paketim (x currency/package)	XXXXXX
2	XXXX	XXXXX	XXXXXX	XXXXX	XXXXXX	XXXXXX	Nr./datë (No./date)		XXXXXX
Ejt. (Etc.)	XXXX	XXXXX	XXXXXX	XXXXX	XXXXXX	XXXXXX	Nr./datë (No./date)		XXXXXX

* Pasaktësitë lidhur me të dhënat e mësipërme, do të konsiderohen të pavlefshme dhe nuk do të merren parasysh (Any discordance with regard to the above mentioned data, will not be considered and will not be taken into account).

Emri i deklaruesit
(Name)

Nvshkrimi
(Signature)

Funksioni
(Function)

Vendi
(Place)

Data
(Date)

**UDHËZIM**

Nr. 12, datë 29.9.2014

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 31,
DATË 20.1.2001, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRFITIMET NGA
STATUSI I INVALIDIT, PARAPLEGJIK
DHE TETRAPLEGJIK”,
TË NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, dtë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, të pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001 “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, bëhet 9 900 (nëntëmijë e nëntëqind lekë në muaj).

2. Masa e përfitimit për kujdestarinë e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, bëhet 10 400 (dhjetëmijë e katërqind) lekë në muaj.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtator i vitit 2014 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2014, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

4. Udhëzimi nr. 5, datë 7.8.2013 i ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Erion Veliaj**

UDHËZIM

Nr. 13, datë 29.9.2014

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 618,
DATË 7.9.2006, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE TË DOKUMENTACIONIT
DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË
PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI
TË KUFIZUAR”, TË NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të pikës 27 të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, e përcaktuar në pikën 8, të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 9 900 (nëntëmijë e nëntëqind) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi të kufizuar.

2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 9 900 (nëntëmijë e nëntëqind) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2 të vendimit dhe 10 400 (dhjetëmijë e katërqind) lekë në muaj për kujdestarin.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2014 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2014, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

4. Udhëzimi nr. 6, datë 7.8.2013 i ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Erion Veliaj**

**UDHËZIM****Nr. 14, datë 29.9.2014****MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 277,
DATË 18.6.1997, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRFITIMET NGA
STATUSI I TË VERBRIT”,
TË NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të pikës 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të

Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997, bëhet 11.250 (njëmbëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë në muaj. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i të verbrit.

2. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2014 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2014, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

3. Udhëzimi nr. 7, datë 7.8.2013 i ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 1.9.2014.

**MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Erion Veliaj**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja “Kristalina”
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 28 lekë